

VENDIM
Nr. 291, datë 15.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MONETARË NË PROCEDURAT E
PROKURIMIT PUBLIK, KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT¹**
(Ndryshuar me VKM nr. 331², datë 13.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kufiri monetar është vlera monetare, sipas së cilës përcaktohen rregullat procedurale, kryesisht në përcaktimin e afateve kohore në procedurat e prokurimit publik të sektorit klasik dhe sektorial për punë, shërbime, mallra, si dhe konkuret e projektimit.

2. Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet me qëllim shmangien e kufirit monetar apo të procedurave të parashikuara nga ligji për prokurimin publik.

3. Kufijtë monetarë ndahen, si më poshtë vijon:

- a) kufiri i lartë monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;
- b) kufiri i ulët monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;
- c) kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike;
- ç) kufiri monetar për prokurimet me vlerë të vogël.

KREU II
KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK
(Ndryshuar togfjalësh në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 me VKM nr. 331, datë 13.5.2026)

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 528 781 400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë;

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik”, dhe që shfuqizon direktivën 2004/18/KE”, të ndryshuar. Numri CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 65–242.

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjektet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar. Numri CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 243–374.

² VKM nr. 331, datë 13.5.2026 në Kreun II “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, pika 1 shprehet; “1. Procedurat e prokurimit publik të nisura me kufijtë monetarë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të vijojnë të zhvillohen sipas kufijve të parashikuar në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, në fuqi, në momentin e nisjes së tyre”.

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 13 699 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

KREU III

KUFIJTË MONETARË NË KONTRATAT SEKTORIALE

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me VKM nr. 331, datë 13.5.2026)

1. Kufiri i lartë monetar në kontratat sektoriale është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 528 781 400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 42 271 200 (dyzet e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në kontratat sektoriale është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

KREU IV

KUFIJTË MONETARË PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE

1. Kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike në sektorin klasik është e barabartë ose më e madhe se vlera 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekë.

2. Kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike në kontratat sektoriale është e barabartë ose më e madhe se vlera 109 000 000 (njëqind e nëntë milionë) lekë.

KREU V

KUFIJTË MONETARË PËR PROKURIMET ME VLERË TË VOGËL

1. Kufiri monetar për prokurime me vlerë të vogël është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Për vlerën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë autoriteti ose enti kontraktor nuk u nënshtrohet procedurave të prokurimit publik, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

KREU V/1

KUFIRI MONETAR PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT

(Shtuar Kreu me VKM nr. 331³, datë 13.5.2026)

³ VKM nr. 331, datë 13.5.2026 në Kreun II, pika 2 "Dispozita kalimtare dhe të fundit", paragrafi i dytë

Kufiri minimal monetar për koncesionet dhe partneritetin publik privat është 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e prokurimit publik të nisura me kufijtë monetarë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të vijojnë të zhvillohen, sipas kufijve të parashikuar në rregullat e prokurimit publik në fuqi në momentin e nisjes së tyre.

2. Kufijtë monetarë të përcaktuar në aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

shprehet;

.... “ Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 4, të kreut I, të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.